



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VII /2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7(shtatë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 21.07.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Znj.Saranda Bajraktari	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z. Driton Maliqaj	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyqi	Z. Xhevxhet Gashi	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Z.Edon Sadikaj	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Dardan Berisha	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Bajram Basha	Z.Xheladin Sadik
Znj. Bulëza Kuçi	Znj.Mevlude Kabashi	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z.Alban Berisha	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Liridon Fandaj	
Z. Reshat Selimaj	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Lirim Qatani	Znj.Festë Kabashi	
Z. Aziz Bytyqi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Sanie Kuçi	Znj. Jehona Rrafshi	
Rexhepaj		
Znj.Mimoza		
Bajrakatari		
Znj.Fidaije Kukaj		
Znj. Afërdita Morina		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

Rend dite

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2021;**
- 6. Informatën për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Qershor 2022;**
- 7. Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2022;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pyet a ka vërejtje në procesverbal.

Sheqerije Zyrapi - te pyetja ime e pare,mungon përgjigja e Kryetarit.

Kryesuesi - e hedh në votim me vërejtjen që u tha.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. . Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Më intereson të di pse në Agro Zonë po mungojnë investimet serioze të Komunës? Sepse mos interesimi i bizneseve për të mos u vendosur,po vjen si pasojë që Komuna nuk ofron kushte në këtë zonë.Pa rrugë të asfaltume brenda zonës,pa ndriçim,me rrjet të ujësjellësit e kanalizimit jofunksional,si po mendoni që do të krijohet kushte që të rritet interesimi i bizneseve që të vendosen në atë zonë?Kryetari Muharremaj ka premtuar edhe zona tjera ekonomike,por nuk po është në gjendje që të investojë edhe në ato zona që janë aktualisht të gatshme për investim.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.Vitin e kaluar kemi marrë 10 prona te Agro Zona për arsye se nuk i kanë kry investimet.Edhe tjerat kemi mi marrë,pra ata që skanë punu.Ka qenë rryma,kanalizimi,uji,por rrymën e kanë vjedh dhe momentalisht nuk funksionon asnjë biznes.Nëse nuk fillon me punu askush atëherë do të ulemi dhe do ndryshojmë destinimin e kësaj zone.

Selman Kolgeci - pikërisht ky është shqetësimi jonë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

18 për, 3 kundër, 3 apstenime
Miratohet pika 2

Pika 3. . Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë, hap debatin dhe kërkon propozimet nga partitë politike.

Aziz Bytyqi - ne propozojmë Saranda Bajraktarin.

Dorentinë Zenelaj - ne emër të grupit të LDK-së propozojmë Kushtrim Kuçin.

Kryetari - nga ekzekutivi propozoj Visar Kuçi dhe Armend Krasniqi, ndërsa nga shoqëria civile Zana Gashi.

Bulëza Kuçi - faleminderit që e keni marrë parasysh kërkesën tonë,mirëpo më intereson të dijë kush është Zana Gashi.

Kryesuesi - është nga Hendikosi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Saranda Bajraktari,Kushtrim Kuçi,Visar Kuçi, Armend Krasniqi dhe Zana Gashi.

Miratohet Unanimisht

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron këtë pikë, hap debatin dhe kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - nuk kemi propozim për këtë komision.

Selman Kolgeci - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Elmaze Bytyqi.

Mevlude Kabashi - në emër të PDK-së propozojmë Dardan Berishën.

Kryetari - nga ekzekutivi propozoj Albulena Kokollari dhe Enver Shabani dhe nga shoqëria civile Erëza Muqa.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Elmaze Bytyqi ,Dardan Berisha,Albulena Kokollari,Enver Shabani dhe Erëza Muqa.

Miratohet Unanimisht

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2021;

Kryesuesi - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Ka një kohë që unë flas e kërkoj që ky pushtet qasjen ta ndryshoj. Poashtu ka një kohë që Kryetari Muharremaj krekoset me të arriturat e tij.Disa nga ju mendimet e kritikave e mia i trajtojnë thjesht si një zë opozitar që ka obligim të bëjë një gjë të till.Disa e dinë mirë për çfarë po flas,i besojnë e i kanë parë kritikave që unë bëj,disa edhe nga pushteti i besojnë asaj që unë them dhe nën zë e pranojnë që kam të drejtë.Sot nuk është koha të flas opozita,sot nuk është koha të flas as pushteti,sot është koha të flas raportit të auditimit.Qytetarë të nderuar,unë e kam lexuar e analizuar këtë raport prandaj mund të them që ky raport i jep të drejtë kritikave tona që kemi bërë në vazhdimësi ndaj qeverisjes Muharremaj dhe në të njëjtën kohë dëshmon për një qeverisje pa plan e strategji,me teke pa vision për ecjen e Komunës sonë drejt zhvillimit e ligjshmërisë.Unë do ti adresoj disa nga të gjeturat e këtij raporti që janë të paraqitura në raportin e auditimit.1. Mos hartimi i projekteve ekzekutive për projektet kapitale.Pra siq shihet nga raporti i auditimit ,në disa nga projektet kapitale nuk ishte zbatuar kërkesa ligjore, që për secilën kontratë të punës duhet të hartohet një projekt ekzekutiv.Kryerja e procedurave të prokurimit pa një projekt ekzekutiv të hartuar paraprakisht mund të ndikoj në mos arritjen e cilësisë së duhur të punimeve.E në fakt ne të gjithë jemi dëshmitar të cilësisë së punimeve nga kjo qeverisje .Gjetje tjetër është mos pagesa e faturave brenda afatit 30 ditë.Sipas raportit të auditimit ky pushtet gjatë vitit 2022 ka kryer pagesa në vlerën prej 1.058.033 euro apo 2010 raste të pagesave ndaj furnitorëve të cilat i kanë kaluar afatet ligjore prej 30 ditësh.Kjo shkelje ligjore tregon logjikën e këtij pushteti dhe paafësinë e tyre për të veprur sipas ligjit dhe atë në 2010 raste.Gjithëashtu nga kjo shkelje Komuna mund të jetë subjekt i padive nga operatorë të ndryshëm ekonomikë duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore e përmbarimore.Gjetje tjetër është: magnesia në procesin e vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve.Bazuar në raport rezulton që Komuna ka përzgjedhur si fitues të subvencione edhe OJQ të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara.Kjo paraqet dëmtim të buxhetit dhe jo transparencë publike,atë që ne e kemi thënë në vazhdimësi.Gjetje tjetër është përdorimi jo adekuatë i procedurave të prokurimit.Në disa raste janë lidhur kontrata përmes procedurave të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë,ndërsa do duhej të realizohej përmes procesit të rregullt të prokurimit me procedure të hapur.Gjetje tjetër është pranimi i faturave pa raport të pranimit për shërbimet e kryera.Pranimi i këtyre faturave pa siguruar paraprakisht raportet e pranimit, len hapsirë të pagesave të atyre faturave dhe keqpërdorimin e parasë publike.Të dashur qytetarë, këto janë vetëm disa nga shumë keqpordorime që ky pushtet ka bërë gjatë vitit 2021.Ajo që dua të theksoj është se auditorët kanë gjetur shkeljet e cekura më lartë dhe paramnedoni si është gjendja në teren e këtyre shkeljeve.Paramnedoni tri rrugë në Javor:Hafir Gashi,25 Gushti e

Osman Dalipi,ku është hap tender,janë vlerësu ofertat,është bo kontratë dhe rrugët nuk janë shtru.Unë këtë nuk e pashë që figuron në raportin e auditorit .E sa shkelje tjera janë në teren e nuk figurojnë në raport.Vlerësimi që ky raport bën për Komunën tone është shqetësues dhe gjendja në teren është shumë më e keqe që ky raport e paraqet.Andaj është urgjente që të merren veprime të nevojshme e të menjëhershme nga të gjitha organet kompetente ligjzbatuese për ti trajtuar këto shkelje që ne po adresojmë çdo ditë.Jo thjesht për qëllime politike pozitë - opozitë,por për të mbrojtur interesin qytetarë e vendosjen e ligjshmërisë së munguar në shumicën e vendimeve që ky pushtet merr.

Dorentina Zenelaj - përshendet te pranishem. Para vetes sot kemi nje raport shumë te rëndësishëm për komunën tonë,ku besoj se ju te gjithë i keni parë gjetjet qe jane dhënë: Faqe 3. Është thënë baza për opinion të kualifikuar është: Po ti analizojmë shkeljet si më lartë nënkupton se totali i keqperdorimit financiar arrin vleren rreth 1.5 milion Euro. Ne lidhje me pikën A1: - Ne fund të faqes 7 dhe fillim të faqes 8 është thënë se arsyeja pse kanë ndodhur keqklasifikimet eshte fakti se Kryetari i Komunës ka bërë planifikimin e buxhetit te komunës gabimisht. Kjo nënkupton se gabimet qe janë bërë në buxhetin e komunës jo rastesisht janë bërë të gabuara sepse i lejojnë që të ketë mundësinë kryetari që të vendos vet mbi ate se ku deshiron ta shpenzojë buxhetin dhe kujt deshiron ti bëj favore nga buxheti i komunës. Në lidhje me pikën A2: - Në faqe 8 është thënë se ky gabim ka ardhur si rezultat i mungesës së vemendjes nga zyrtarët e ngarkuar me mbajtjen e evidencave kontigjente si dhe nga pamjaftueshmeria e Kontrollit të brendshëm e cila është e cekur edhe ne faqe 7. Kjo në parim nënkupton se jo rastesisht këta zyrtarë kanë perfshire në detyrime kontigjente punë te cilat veqse janë kryer, sepse Kryetari duke mos krijuar kontroll të brendshëm e te mirëfilltë, i perdorë keta zyrtarë për të vendosur detyrime kontigjente në zëra te caktuar në mënyre qe pastaj ato mjete ti perdor per te shperblyer me tendere persona te caktuar apo per te mbuluar punë te kryera me herët nga kompani te favorizuara nga Kryetari për te cilat projekte nuk kanë qenë të kaluara nëpër procedura te rregullta te prokurimit. Ne lidhje me pikën B1: - Ne faqe 9 thuhet se Zyrtarit të caktuar për regjistrim te pasurise, pas pensionimit të atij qe ka qenë para tij, nuk ju ka dhënë qasja në sistem nga Thesari. Kjo është pasojë e mos kontrollit të brendshëm nga Kryetari dhe si pasojë Kryetari nuk e ka te evidentuar pasurinë e qytetarëve te komunës në vleren e saktë të saj.Për çudi në asnjërën nga dy gjetjet më lartë të cilat kanë të bëjnë me mundësinë e keqperdorimit te buxhetit te komunës Kryetari nuk është pajtuar, por është pajtuar vetëm me gjetjen e fundit e cila ka të bëjë vetem me mos pasqyrim të saktë të pasurisë së komunës.Faqe 4. Është thënë baza për nxjerrjen e konkluzioneve kanë qenë: Nga natyra e mangësive më lartë konkludohet se Kryetari e ruan kontrollin mbi gjithqka dhe ai vetë eshte personi që vendos se ku duhet jepet prioritet për investim, kënd duhet favorizuar nga shoqeria civile (OJQ) kur dhe kujt duhet ti paguhet fatura, kujt duhet ti jepen tenderet si dhe kujt dhe si duhet ti mbledhet tatimi në pronë. Faqe 7. Është thënë: Kjo nënkupton se Kryetari qellimisht nuk ka krijuar një kontroll të brendshëm të duhur, në mënyrë që të ketë mundësinë që të keqperdorë fondet apo të merr vendime sipas interesave qofshin personale apo partiake.Në lidhje me pikën A3: - Në faqe 10 është thënë se për disa projekte nuk janë përpiluar projekte ekzekutive me arsyetimin e zyrtarëve që për të mos vonuar procedurat por është thënë gjithëashtu se kryerja e procedurave të prokurimit pa projekte ekzekutive ndikon që projektet të devijojnë nga kërkesa standarde në tender si dhe ndikon në uljen e cilësise së duhur Kjo shihet qartë se është bërë e qëllimshme vetëm për ti shpërblyer operatoret ekonomikë të preferuar me gjoja punë shtesë në projekt si dhe duke i lejuar që të ulë standardin e punimeve vetëm e vetem per të dalë me profit sa më të mirë. Tjetra që mund të ketë ndikim të madh e që nuk është përmend është edhe

fakti se duke mos pasur projekt ekzekutiv, disa tendere kanë mund të jepen për një projekt të caktuar kurse puna në fakt është kryer në një vend tjetër, sikur kanë qenë rastet që janë shtruar rrugë të cilat nuk reflektojnë si punë nëpër tendere të dhëna, si dhe e kundërta e saj ku ka rrugë që figurojnë se janë shtruar kurse në fakt rruga është e pashtruar fare. Krejt kjo është bërë qëllimshëm në menyrë që Kryetari ti shpërblej votuesit e vet nëpër lagje ku mendon se e ka votën e tyre, ndërsa duke mos punuar fare nëpër lagje ku e din që nuk janë votues të tij. Në lidhje me pikën A4: - Në fund të faqes 10 është thënë se Komuna është futur në obligime pa pasur buxhet gjoja për shkak të neglizhencës së zyrtarëve. Ne konsiderojmë se Auditori ka përdorur shprehje më të buta sepse është munduar që të mos e vëj në pah shumë këtë qështje sepse në fakt kjo qështje është mjaft shkelje serioze. Vonesa në pagesë në fakt nuk ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve sepse edhe po të ndodhte për shkak të keëaj neglizhence paratë do të ishin të disponueshme për tu paguar por vetem procesimi i pagesës mbetet i perealizuar, si dhe në planet buxhetore ato do të duhej të figuronin si detyrime të pakryera kundrejt operatorëve ekonomik. Kjo në fakt ka ardhur si pasojë se disa projekte janë realizuar nga operatorë ekonomik të favorizuar nga Kryetari e të cilat nuk kanë qenë fare të buxhetuara, dhe si pasojë se janë harxhuar mjetet në projekte të pa buxhetuara, nuk kanë mbet mjetet për ti paguar operatorët ekonomikë për projekte të cilat janë kryer në procedura të rregullta. Kjo vërtetohet edhe në fillim te faqe 11 te pika “ndikimi” ku thuhet se si pasojë e kesaj vonese komuna nuk mundet të beje planifikimin e likuiditetit. Pra rrezikohet Komuna që të mbetet pa para dhe si pasojë të falimentoj vetë komuna nëse këta Operatorë Ekonomikë do të angazhonin përnjehër të gjithë se bashku një përmbarues që ti merren komunës në menyrë të dhunshme mjetet nga buxheti i saj. E çuditshmja e krejt kësaj është se Kryetari nuk ka mundur as të gjej arsyetim në këtë qështje dhe është pajtuar me gjetjen , gjetje kjo e cila përben rrezikun më të madh në këtë raport. Në lidhje me pikën A5: - Në faqe 11 është thënë se është bërë ndarja e subvencioneve për OJQ duke mos e respektuar fare kërkesat e rregullores për vleresim gjoja si pasojë e neglizhencës së komisionit. Edhe në këtë pikë mendojmë se Auditori ka dashur që të mos e vë shumë në pah këtë rrezik të caktuar sepse kjo nuk është e saktë që ka ndodhë për shkak të neglizhencës por për shkak të ndikimit që Kryetari ka pasur në këto komisione, dhe për shkak se Kryetari pa procedura të vlerësimit ka shpërblyer qoftë OJQ qoftë gazetarë të ndryshëm për të shpërndarë lajme të mira në publik për Kryetarin. Kjo vërehet qartë edhe në faqe 11 te pjesa e ndikimit se ndarja e subvencioneve duke mos respektuar kriteret e parapra per thirrje publik, përbën dëmtim të Buxhetit si dhe jo transparencë Publike. Pra Kryetari jonë është shumë normale që ka qen jo transparent sepse Jo transparenca e tij i ka mundësuar të njejtit që ta keqperdorë Buxhetin dhe ta dëmtoj të njejtën gjë që po vërtetohet edhe nga pikat e trajtuara më lartë, si dhe duke mos qenë transparent dhe duke keqperdor buxhetin ka paguar media të ndryshme që të japin lajme pozitive për të duke u munduar që ta fsheh tërë këtë jo transparencë përmes lajmeve falco të paguara me paratë e buxhetit të komunës përmes një procesi jo transparent. Si dhe për çudinë më të madhe edhe Vet Kryetari e ka pranuar pa fije turpi këtë shkelje kaq të rëndë sepse e ka pasur të pamundur ta kundërshtojë. Ne lidhje me pikën A6: - Në faqe 12 është thënë se sipas zyrtarëve të komunës, në mungesë të njohurive ka ndodhur shkelja në fushën e teknologjisë së informacionit. Ne konsiderojmë se nuk duhet të kemi njohuri të mëdha për të ditur se sipas kontratës një shërbim i skanimit ka mund të paguhet me rreth 3,000 € dhe është paguar me rreth 22,000 € që i bie se ka dëmtim të buxhetit për rreth 19,000 €. Edhe nëse ka ndodhur për shkak të mos njohurive, do të duhej që ata persona të japin përgjigje për këtë gabim fatal i cili ka rezultuar me dëmtim të buxhetit për rreth 19,000 euro duke e paguar një shërbim për 600% më shtrenjtë

se sa çmimi real i tij. Në pjesën e Ndikimit thuhet qartë se kjo ka rezultuar në keqpërdorim të parasë publike. Dhe Kryetari jonë duke qenë i vetëdijshëm që e ka keqpërdorë paranë publike ka rënë para një fakti të parevokueshëm dhe e ka pranuar këtë shkelje duke mos e kundërshtuar. Në lidhje me pikën A7: - Në faqe 12 është thënë se sipas zyrtarëve të komunës, mosrespektimi i procedurave të prokurimit ka ndodhur si pasojë e mungesës së Planifikimit të Aktivitetit të Prokurimit. Edhe në këtë pikë mendojmë se Auditori ka përdorur fjalor të butë duke mos dashur ti jap një kontacion meritore një çështje tepër të ndieshme. Ne konsiderojmë se mosrespektimi i procedurave të prokurimit ka ndodhur me qëllim të shpërblimit të Operatorëve Ekonomikë të preferuar nga vet Kryetari dhe kjo së bashku me shkeljet e tjera si më lartë i kanë lejuar Kryetarit që të shpërblejë kë të dojë me sa të dojë në shkëmbim të votave. Te pjesa e NDIKIMIT është thënë se përdorimi i procedurës së negociimit pa publikim fare për kontratë le hapësirë të kufizimit të konkurrencës. Ne mendojmë se përveq që kufizon konkurrencën kjo ndikon direkt edhe për të shpërblyer një operator ekonomik të caktuar me tender. Përveq kësaj lejon që projekti të blehet më shtrenjtë, që do të dëmtonte buxhetin sepse nëse do të ishin përfshirë edhe operatorë të tjerë me ofertat e veta, është e sigurt që ky proces do të kishte ndikuar edhe në një çmim real për tenderin e që mund të ishte çmim më i ulët se sa ai i negociuar nga vet Kryetari. Në lidhje me pikën B2: - Në faqe 13 është thënë se janë dhënë zbritje të lejuara për tatimpagues edhe për ata të cilët nuk kanë numer personal dhe pa deklaratimet e tyre në lidhje me vendbanimin parësor. Kjo ka rezultuar me përlllogaritje të pasaktë të tatimit në pronë dhe si pasojë edhe me të hyra më të ulëta të tatimit në pronë. Të hyra më të ulëta të tatimit në pronë nënkupton dëmtim serioz i buxhetit të komunës, e të bërë nga Kryetari jonë si pasojë e keqmenaxhimit të komunës, dhe për çudi edhe kjo gjetje është pranuar nga ana e tij. Në lidhje me pikën B3: - Në faqe 14 është thënë qartazi se Kryetari në mungesë të Kontrollit të brendshëm nuk ka arritur që të menaxhojë të arketueshmet e si pasojë e kësaj nuk ka mundur që ta rritë realizimin e projekteve që financohen nga burime vetanake. Në fakt shumica e gjetjeve janë të lidhura me Kontrollin e Brendshëm jo adekuat dhe ne mendojmë se kontrolli i brendshëm me qëllim nuk është duke u sforcuar nga Kryetari sepse i njejtë dëshiron që ti ketë duart më të lira në vendimarrje kur vjen në pyetje shpenzimi i buxhetit të komunës. Këtë e bazojmë edhe në faktin se kontrollin e brendshëm do të ishte ndoshta problem ta ndërtoje nëse je në vitin e parë të mandatit të parë por ne jemi duke folur tani për një mandat të dytë të këtij Kryetari dhe moskontrolli i brendshëm më nuk është neglizhencë por është e qëllimshme. Në lidhje me pikën A8: - Në faqe 15 shihet qarte se shkelje mjaft serioze është edhe pranimi i faturave të operatorëve ekonomik pa raport të pranimit të punëve. Në pjesën e ndikimit është thënë qartazi se kjo ndikon direkt në keqpërdorimin e parasë publike. Por ne konsiderojmë se përveq që ka ndikuar në keqpërdorimin e parasë publike, kjo i ka mundur Kryetarit që të shpërblejë operatorë ekonomik të preferuar pa përfilljen fare të shumë procedurave tjera si më lartë dhe kësaj të pranimit të punëve. Në bazë të të gjeturave të këtij raporti, duke mos krijuar një kontroll të mbrendshëm dhe duke mos përfill shumë procedura të përmendura në raport, ne konkludojmë se Komuna e Suharekës nuk ka vetëm Kryetar z.Bali Muharremaj por e ka një Kryetar totalitar që është z.Bali Muharremaj i cili merr vendime sipas mendjes së vet duke mos përfill procedurat bazike për marrjen e tyre.

Kryetari - dy vitet e fundit zyrën e prokurimit e ka përcjell USAID. Asnjë punë e madhe nuk bëhet pa projekt. Krejt e tha te ligji i negociimit. Një projekt ka qenë gjithë vitin, për arsye se lënda ka qenë në OSHP. I njejtë raport vitin e kalum ka qenë shumë i mirë dhe kjo që po ndodh, po ndodh me 26 Komuna. Edhe vitin e kalum, edhe para tre vjete, e kem dit që jem tu bo keqklasifikim. Edhe këtë vit ka

keqklasifikim dhe ka me pas edhe vitin e ardhshëm keqklasifikim por jo keqmenaxhim, për arsye se i kem kërkesat që kur t'kalon korniza buxhetore në Japim mendimet tona se buxheti nuk ndryshon në qoftëse është 17 milion, por në kërkojmë sa duhet me pas investime, sa mallra dhe shërbime, sa subvencione dhe sa paga meditare. Çdo vit është duke u punu dhe shtohet numri i rrugëve. Te regjistrimi i pasurisë, ju e dini që ne, që dy vjet s'kemi pranë punëtor në Komunë dhe nuk mundemi me autorizim askënd me bo regjistrimin e pasurisë pasi që ka shku në pension. E dini që ka ndryshu ligji për marrjen e punëtorëve në punë, dhe nuk kemi mujt me i kompenzu. Sa i përket fshatit Javor, ajo është bo publike me miratimin e dy kryesive të fshatrave, rruga që e lidh fshatin me fshat, sepse nxënësat e fshatit Luzhnicë shkojnë në Javor në shkollë.

Urim Suka - është e papranueshme qasja e Kryetarit ndaj asambleistëve. Çka shkruj na, çka lexoj na dhe çka bëj na është çështja jonë. Në sot po i lexojmë të gjeturat e raportit dhe nuk po i thojmë fjalët tona, dhe Kryetari mundet me na kthi vetëm përgjegje për të gjeturat e auditorit. Te pjesa e Javorit, e di mirë çka ke bo. E ke në kod edhe rrugën e Luzhnicës. Me bo marrëveshje dy kryesitë e fshatrave nuk figuron kërkun në ligj. Nëse don me ndërru atë lëndë, duhet me pru në Asamble, por ti ke bo kontratë për atë rrugë dhe e ke qu tjetër kund, dhe kjo është shkelje. Tu kisha lut të merresh me detyrat e tua dhe leje opozitën le ta ban punën e vet ashtu qysh din ajo. Sot po flasim për raportin e auditorit dhe përgjigju gjetjeve. Tri nga rekomandimet i ke të përsëritura. Rati i Javorit është veq si mostër dhe aso raste ka gati në çdo vendbanim. Reflekto, është opozitë dhe po të them, e ke gabim dhe ndrysho sepse është gabim.

Kryetari - a reflektoj a jo është qështje e imja. Janë organet e hetuesisë dhe prokurorisë dhe krejt çka keni dorëzoni. Por nuk është lehtë me i thënë dikujt po vjedh sepse duhet me pas argumente.

Qëndrim Elshani – Në raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës për vitin 2021 hasim në shumë keqmenaxhime , e unë po i permendi disa prej tyre:

1. Sipas raportit të auditorit janë keq-klasifikaur shpenzimet në kategori ekonomike, ku këto paraqesin pamje jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare, duke prezantuar informacione jo të drejta për kategori përkatëse të shpenzimeve. Këto keq-klasifikime kanë ndodhur si pasojë e asaj se këto shpenzime janë planifiku dhe buxhetu gabimisht. (Qeshtja A1 faqe 7).

2. Keq raportim tek detyrimet kontigjente, e kjo si rezultat i mungesës së vëmendjës së zyrtarëve që evidentojnë detyrimet kontigjente. Ky keq-raportim mund të ketë implikime në mbulimin e detyrimeve financiare në vitet e ardhshme. (Qeshtja A faqe 8)

3. Keq-raportim tek pasuritë kapitale ku kishte një diferencë prej 694,912 Euro në mes të blerjeve gjatë vitit 2021 dhe regjistrimit të pasurive kapitale, e gjithashtu keq-raportim edhe tek pasuritë nën 1000 Euro. Këto keq-raportime na lënë të kuptojmë në keq-menaxhim nga zyrtarët përgjegjës, si dhe në prezantim jo të drejtë të pasurive në pasqyrat financiare. (Qeshtja B1 faqe 9)

4. Janë hartu projekte të cilat nuk janë zbatu kërkesat ligjore, që për secilën kontratë të punës duhet të hartohet një projekt ekzekutiv, ku për këto projekte ishin përgaditur vetëm paramasat dhe përlllogaritjet, ku këto mos-perfillje ligjore mund të kenë implikim që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarte të ndertimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur. (Qeshta A3 faqe 10)

5. Mos-pagesa e faturave brenda afateve ligjore nga komuna mund të ketë pasojë duke rezultuar në pagesa përmes vendimeve përmbarimore si dhe në pagesa shtesë si rezultat i padive, e duke ndikuar keshtu në aftësinë për menaxhim të likuiditetit të komunës. (Qeshta A4 faqe 10)

6.Sa i përket procesit të vlerësimit të aplikacioneve për subvencionimin e OJQ-ve, rezulton se komisioni vlerësues ka përzgjedhur përfitues pa i përmbushur kriteret e parapara në thirrjen publike, ku ky keq-vlerësim paraqet dëmtim të buxhetit të komunes dhe jo transparencë publike. (Qeshta A5 faqe 11).

7.Komuna nuk kishte marrë pelqimin paraprak për projektin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit siç e parasheh rregullorja nr. 06/2018, që për inicimin e projektit institucionet marrin pelqimin nga Agjensia e Shoqërisë së informacionit, për blerje të softwerit për digjitalizim të arkivës. Gjithashtu komuna në këtë kontratë kishte përfshirë edhe shërbimin e skanimit me çmim 0.04_€uro për faqe ndërsa sipas kontratës ishte 0.0061_€uro, ku nga kjo kontratë komuna është dëmtuar rreth 18,852_€uro. (Qeshtja A6 faqe 11)

8.Komuna gjithashtu nuk ka zbatuar procedurat e prokurimit publik sipas nenit 32.1 ku për një aktivitet të prokurimit autoriteti kontraktues duhet të shfrytëzojë procedurë të hapur ose procedurë të kufizuar, e ku përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë nënkupton kufizim të konkurrencës. (Qeshtja A7 faqe 12).

9.Sipas raportit të zyrës së auditorit komuna ka vazhduar me trend rritës të llogarive të arktueshme, ku ky trend i rritjes së vazhdueshme do të ndikoj në realizimin e projekteve të cilat finacohen nga burimet vetanake. (qeshta A8 faqe 14)

10.Komuna ka shkelur rregulloren finaciare nr. 01/2013 për Shpenzimet e parave publike në nenin 24 për pranimin dhe pagesën e fatures, ku komuna ka pranuar fatura pa siguruar paraprakisht raport të pranimit të shërbimit.Pranimi i faturave pa siguruar paraprakisht raport të pranimit të shërbimit,ngreh dyshime për pagesa të faturave dhe të keq-përdorimit të parasë publike. (Qeshtja A8 faqe 15).

Sa i përket përgjegjesive, Kryetari i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës, e ketu na del Kryetar që keni qenë një menaxher i dobët. Ne i bejme thirrje publike institucioneve për një hetim të këtij raporti.

Kryetari - edhe një here po them,ka keqklasifikim dhe jo keqmenaxhim.Kjo nuk ka me ndryshu deri sa nuk aprovohet buxheti në bazë të kërkesave të qytetarëve të Komunës sonë.Qe 18 muaj nuk kem pas mundësi me marrë punëtor për shkak të ligjit të ri.Te fotokopjet,nuk është projekt i joni,ai është i qeverisë.

Selman Kolgeci - sa i përket raportit është se ju z.Muharremaj duhet të pranoni se paaftësia juaj qeverisëse tashmë po pasqyrohet në dokumenete zyrtare.Në bazë të opinionit të auditorit ju rrezikoni të mos përfitoni shumë grante gjatë vitit 2022 si pasojë e opinionit të modifikuar.Këto të gjetura,ky rezultat dhe ky keqmenaxhim i shprehur në raport ka të bëjë vetëm me lëndët të cilat janë punuar si mostra.Nëse të gjitha lëndët do të iu kishin nënshtruar auditimit,këtyre të gjeturave do t'ju kishin shtuar edhe shumë të gjetura e shumë rekomandime tjera.Si pasojë e mos regjistrimit të plotë të asateve kapitale dhe jo kapitale, Komunës sonë i janë nënvlerësuar 1,218,732.00 euro,dhe e keni arsyetuar me pensionimin e një zyrtari. Pensionimi i zyrtarëve nuk ndodh spontanisht,ajo dihet dhe duhet ndërmarr masa me kohë që të bëhet rekreatimi i zyrtarëve të rinjë me qëllim të paisjes me autorizime të nevojshme për mbarëvajtjen e punës.Ju saktë e dini se kur dalin në pension zyrtarët sikurse e dini se kush do të jetë pasardhës i tij.Pra, kjo thënë nga ju nuk e arsyeton zhvlerësimin në nivel kaq të madh të pasurive kapitale dhe jo kapitale të Komunës.Veprimet e nënvlerësimit të pasurive ndodhin kur dikush keqpërdor pozitën dhe zhvlerëson ndonjë ndërmarrje shoqërore apo private,me qëllim që atë ta marrë më lire në këmbim të një të mire materiale për vetin apo planin e tij. Kam ngritur shqetësim në seancën e datës 24.12.2021 se ju keni

planifikuar buxhet por nuk keni planifikuar as hartim të projekteve,as mbikqyrje të projekteve.Kjo është raportuar si e gjetur në disa projekte për vitin 2021.Jeni pajtuar me të gjeturën se nga mospërdorimi i kontratës së Agjencisë Qëndrore të Prokurimit për skanimin e dokumenteve e keni dëmtuar buxhetin për 18,885.00 euro,dhe krejt kjo me arsyetimin se nuk keni pas njohuri për këtë.E keni shkruar vet si arsyetim dhe tash po thoni që është kontratë e dikujt tjetër. Keni pranuar fatura të paguar të njejta në vlerë prej 22,708.00 euro pa situacion,ndërsa në arsyetimin keni thënë se ka ndodhur si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrollorëve të brendshëm.Unë pajtohem që jo vetëm kontrollorët e brendshëm,por edhe komplet qeverisja juaj nuk funksionon dhe këtë e them me keqardhje.

Kryetari - edhe një here e them në mënyrë publike,lëndët janë kanë në OSHP dhe momentalisht 3.2 milion euro janë të bllokune.Kuptoni, disa gjana që vin prej naltit janë të parapara me ligj dhe ne nuk e ndryshojmë.Që e ceke që s'ka me pas grande,për 4 vjet 10 milion euro donacion janë kanë.Por edhe grande i kemi mbi 2 milion euro këtë vit dhe grandet s'kan mu nal në Komunën tone asnjëherë.

Selman Kolgeci - nuk thash që kanë mu nal,por rrezikojnë mu nal.Te qështja e kontratave me negociim,nuk jam kundër kontratave me negociim,e di që duhet mu bo por për raste specifike,jo për furnizim me dru.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit.Me që raportet e auditorit janë të përvitshëm dhe vazhdimisht ka të gjetura e që është normale.Kështu që ka pas çdo herë raport të tillë,edhe në 2013 dhe në 2014, e kujtoni.Ndërlidhem te kolegu Qëndrimi ku vazhdimisht e citonte dhe thoshte, zyrtarët komunal dhe keqklasifikimi - keqmenagjimi,që realisht është e vërtetë.Janë afatet ligjore se kur do të bëhet pagesa,por nuk është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës ta përcjell faturën,se prap lind dyshimi se Kryetari po interesohet për faturën e x-it. Për të gjitha pikat e raportit të auditorit ka zyrtarë përgjegjës në këtë aspekt. E cituat digjitalizimin e arkivës. Digjitalizimi ka qenë projekt afërsisht 40 mijë euro dhe në këtë projekt ju e përmendët vetëm skenimin e dokumeneteve.Skenimi i dokumeneteve është një projekt prej AQPS-së i lidhur për gjashtë vite e që as një komunë nuk është e kënaqur me këtë projekt e së cilën kemi qu vazhdimisht shkresa e kërkesa për shkëputjen e kontratës të operatorit ekonomikë,mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodh asnjëherë.Te kontrata e digjitalizimit të arkivës kanë qenë dy softwera dhe janë dhe dy fotokopjues ,e në këtë rast komuna nuk ka pas nevojë me përdor digjitalizimin përmes projektit e me bo shpenzim të dyfishtë,por operatori ekonomikë në kuadër të kontratës e ka pas edhe skenimin e lëndëve së bashku me personat përgjegjës.Dua të citoj që me ligjin e ri zyra kombëtare e auditimit për çdo lëndë e cila ka parregullsi dhe lëndë e cila i nënshtrohet një hetimi,e ka të drejtën me qu në prokurori dhe nuk ka nevojë me bo na thirrje.

Urim Suka - opinioni i auditorit është i modifikum,që do të thotë që ka keqklasifikim e keqmenaxhim.E jona është me lexu raportin dhe me ja thënë juve,e juaja nuk është me na kritiku neve pse i kena gjet.E juaja është me i pa këto të gjetura e me kqyr mi përmirësu vitin e ardhshëm dhe me i nal ato shkelje.

Kryetari - unë nuk jam auditor.Edhe këtë vit janë të njejtat shkelje dhe keni me pas edhe vitin tjetër të njejtat shkelje deri sa nuk na oprovohet buxheti në bazë të kërkesave të qytetarëve.Nuk mujna me 400 mijë euro mallra dhe shërbime me i kry detyrat tona.

Urim Suka - 2010 raste i ke vonu pagesat e faturave dhe 30 ditë ke pas afat me i pagu ato.Projekte kapitale po realizon pa projekt ekzekutiv.Këto s'ki nevojë mi bo sepse janë shkelje direkte dhe te këto reflektoj.

Kryetari - pse si kam përcaktu këto gjana, me 27 më sheh me ambasadorin amerikan duke e nënshkru një marrëveshje të re, për shkak se na ka zgjedh një ndër 5 komunat.

Alban Berisha - edhe unë pajtohem me Dritonin që tha që janë zyrtarët komunal që i kryen punët. Por kur po vje puna me dal diçka mire, thoni u bo, u bo, por kur po bohet keq, ka zyrtarë. Ka shumë zyrtarë që kryejnë punë me nder dhe përkushtim. Kisha kërkua nga ekzekutivi që kur t'ja merrni meritat, mos ja leni edhe kritikën. Pse asnjëherë nuk e kam ndëgjju asnjë drejtor ose Kryetarin duke thënë që e kemi një administratë shumë të mire, por administrata është vetëm një shigjetë me gjujt kur ka kritika. Është e vërtetë që ato vërejtje që janë bo këtu, disa janë të lehta dhe disa të rënda. Janë zyrtarët që i kanë bo disa lëshime dhe realisht Kryetari duhet me na dhanë përgjegjësi. Por kur të bëhen disa të mira kisha pas qef që ata zyrtarë mu kanë në Ambasadën e Amerikës tu nënshkru kontratë.

Kryetari - ke të drejtë. A është mire në qoftëse një Kompani e ka kry punën 22 mijë euro dhe nuk e ka prur raportin dhe me ja lëshu parat.

Driton Maliqaj - pajtohem me Albanin. Shërbyesit civil janë alfa dhe omega e komunave dhe institucioneve publike dhe pa ta nuk mund të funksionojë asnjë shërbim. Pse Kryetari dhe merita është e Kryetarit. Merita është përshkak se udhëheq politika dhe Drejtorët e Drejtorive i përfaqësojnë politikën e Kryetarit. Politikisht udhëheq me politika dhe merita dhe e keqja i takon prap Kryetarit.

Pika 6. Informatën për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën Janar-Qershor 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - nga 3,586,588.85 euro të parapara për investime kapitale gjatë vitit 2022, vetëm 5.04 % janë investu. Poashtu kanë thënë që pjesa tjetër do të shpenzohet deri në fund të vitit fiskal. Pra, kjo qeverisje synim e ka si ti shpenzoj ato mjete dhe jo si ti investoj dhe kjo është shqetësuese. Sipas këtij raporti, shpenzimet e zyrës së Kryetarit, drejtorive dhe njesive tjera, shpenzime për pije dhe ushqim, telefoni mobile e shpenzime për vendim të gjykatave, kanë shpenzuar rreth 460 mijë euro. Përpos disa abrokacioneve në facebook nuk qenka punuar asgjë këto gjashtë muaj. Kërkoj që të jeni më të ndërgjegjshëm dhe më të arsyeshëm me paratë publike.

Urim Suka - sot kur e analizoj shpenzimin e buxhetit për periudhën janar-qershor të këtij pushteti, e kuptoj se sa të kundërta janë deklaratimet dhe krekosjet e tyre në portale e media me realitetin e ekzekutimit të buxhetit në teren. Kam dy dyshime për disa shpenzime. Shpenzimi që është për mirëmbajtjen dhe riparimin e veturave në vlerë 7,891.00 euro te Drejtoria e Shërbimeve Publike, kërkoj një arsytim. Shpenzimi tjetër që kamë hasë është te Drejtoria e Arsimit, ku janë shpenzuar 60,329.00 euro për udhëtime zyrtare brenda vendit.

Enver Shabani - kryesisht investimet janë bo në kamiona për zjarrëfikje dhe shpëtim dhe ju e dini që teknika është mjaft e vjetër. Drejtori tutje jep sqarime.

Fadil Hoxha - te raporti i administrimit të buxhetit janar-qershor që e keni para vete, këta tregues që i keni, këta tregues janë realizu. Te projektet kapitale, realisht shpenzimi është i vogël krahasuar me pjesën e alokimit, mirëpo ka ndërru formë e mënyrës së alokimeve me pjesën e shpenzimeve. Me ligjin e ri, me plan keshin kanë dalë disa probleme që realisht po paraqiten me rastin e shpenzimeve, ku planifikimin te zotimi e len sa është buxheti. Zyrtari Kryesor financiar tutje jep sqarime rreth kësaj. Ndërsa sa i përket

pyetjes rreth shpenzimeve të administratës së arsimit,udhëtimet brenda vendit janë transporti i nxënësave.Sa i përket shpenzimit të vendimit të gjykatave,te arsimit fillor kemi 413,747.43 që janë vendime të arsimit,ku futen shujta,udhëtimet dhe paga tjera.

Driton Maliqaj - desha ti them ZKF,a i bie që qytetarët janë të kënaqur me qeverisjen e Bali Muharremaj që kanë pagu kaq shumë.

Kryesuesi - faleminderit !

Selman Kolgeci - s'e di a janë të kënaqur me qeverisjen,apo i keni tut me do postime që keni me i qu te përmbartuesi.

Pika 7.

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - lidhur me informatën rreth aktiviteteve të KKSBB-së më lejoni të theksoj se duke marrë për bazë që ju keni vepru njëanshëm në themelimin e këtij këshilli,edhe pritjet tona kanë qenë të vogla për rezultatet që do të arrihen.Në këtë informatë e kupton se sa pak rëndësi i kushtoni një qështje shumë serioze për qytetarët,pra sigurisë së qytetarëve në përgjithësi.Fakti që për tre muajt e fundit numri i vjedhjeve të shtëpive shënon rritje.Sipas të dhënave që ju keni sjell, janë 50 vjedhje të shtëpive për tre muajt e pare të këtij viti.Këto janë raste të deklaruara por kur kësaj ia shton edhe një numër të konsiderueshë të rasteve që nuk deklarohen fare,e kupton seriozitetin e situates dhe nevoja për veprime konkrete të institucioneve tona është e madhe.Gjithëashtu në bazë të kësaj informate që ju keni sjell, në krahasim me vitin e kaluar rezulton që kemi rritje të veprave penale.Edhe kjo informatë tregon që ju keni neglizhuar këtë situatë dhe nuk e keni trajtuar me seriozitetin e nevojshëm.Sa i përket sigurisë në shkolla përveq trajtimit të situates me Kovid 19,nuk keni promovur asgjë tjetër për rritjen e sigurisë në shkolla.Ndërkohë ajo që më bëri më shumë përshtypje është fakti që ju në këtë informatë keni identifikuar vetëm një lokal që natën në rrugën” Hajdin Berisha” e prish qetësinë publike.Unë nuk mendoj që kjo është gjendja reale sepse sipas informatave që unë kamë,ka edhe shumë raste për prishjen e qetësisë publike.Edhe më shqetësuese është fakti që në këtë informatë ju theksoni që ky lokal që prish qetësinë publike është gjobitur dhjetra here nga policia dhe inspeksioni.Pse duhet të gjobitet me dhjetra here?Ai mund të gjobitet një here apo dy herë ,dhe nëse pas këtyre gjobave nuk e ndërpre zhurmën, masat ndëshkuese duhet të jenë tjera.Dua të theksoj që të trajtohen me seriozitet qështjet e sigurisë publike për qytetarët tanë duke marrë veprime konkrete për parandalimin e rreziqeve eventuale,duke filluar nga mungesa e trotuareve,shenjat në komunikacion,dhuna në familje,parandalimi i dhunës e i dukurive negative në shkolla të mesme,parandalimi i aksidenteve,që sipas informatës që ju keni sjellë tregon se rastet janë në rritje dhe kjo dëshmon neglizhencën e juaj dhe paaftësinë e juaj për me rrit sigurinë e qytetarëve.

Alban Berisha - Kryetar,në cilësinë e Kryesuesit të këtij këshilli janë disa detyra dhe përgjegjësi të cilat ngarkohen për këtë këshill prej momentit që themelohet.Unë sa e shoh çdo vit përsëritet i njeiti raport me disa ndryshime të vogla.Janë disa dukuri në vazhdimësi p.sh. te rasti qentë endacak janë hek dhe u vendos një lokal që bë bën zhurmë,por përmbajtja tjetër është e njejta.Te zjarret po njerrni konkluzion apo rekomandim duke e dit çfarë dame kemi. Pse mos me u bo një plan të veprimit se si me parandalu.Një fakt që më shqetëson mu janë lëndët narkotike në Suharekë dhe nuk e shoh që po përmendet në raport.Ne

si Asamble e kemi themelu këtë këshill,që ky këshill ka të drejtë me bo një plan të veprimit se si me nal këtë,sepse fatkeqësisht është duke u përdor edhe nëpër shkolla.Domosdoshmërisht duhet me qenë një pikë e tillë sa here të mbani takime.Te rasti i rritjes së vjedhjeve,normal nuk mujna me akuzu as një organ por te ndriçimi duhet të jemi ma shumë vigjilent sepse në shumë pjesë të qytetit mungon ndriçimi.Te lirimi i trotuareve,nuk më duket strategjike lirimi i trotuareve vetëm me ndëshkime ndaj mërgimtarëve tonë.Më mire është me bo një plan veprimi,me angazhu njerëz që i orientojnë qytetarët.

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit.Me qenëse kam qenë pjesë e dëgjimit publik në fshatin Mushtisht,banorët e kanë paraqit një kërkesë sa i përket vendosjes së kamerave në disa pjesë të fshatit.A jeni në dijeni për kërkesën e tyre,a do të bëhet diçka,a është legjitime dhe a planifikon ta përmbush ky komision në bashkëpunim me policinë?

Kryetari - jemi në bashkëpunim me policinë dhe ju e dini që ne i vendosim kamerat dhe i kontrollon policia.Është një vendim për me i vendos në Mushtisht, Budakovë dhe është një kërkesë për me përfshi një pjesë të Sudentanit.Në muajin maj kemi fillu me buxhet dhe ka procedura.Mujm me bo qysh dojmë.Është e mire për arsye se policia i kontrollon dhe ka shumë raste që janë zbulu perms kamerave. Vitin e kalum,3 muaj ka qenë në shërbim vetura për organet e policisë nga ora 16 deri në mëngjes dhe këtë vit vazhdon e njejta marrëveshje.KKSB nuk është këshill ekzekutiv por jep rekomandime.Te parkingjet e di që ka mungesë por ka mjaft parkingje jasht tregut javor.Të gjithë ata që e prishin qetësinë, sipas rregullores ato do të mbyllën,por për arsye që është muaji i tolerances sepse kemi numër të madh të mërgimtarëve dhe do të mundohemi me tejkalu këtë muaj.Kryetari tutje jep sqarime rreth kësaj pike.

Alban Berisha - në aspektin e subvencioneve,ju muni me dhanë subvencione dhe si nivelin qëndrore dhe lokal permes subvencioneve ekzekutivi arrin disa objektiva ose qëllime që nuk i ka të përcaktune me ligj.P.sh.kurkush nuk mundet me iu nal që permes subvencioneve me subvencionu një OJQ për me mbajt një trajnim të karakterit joformal nëpër shkolla.

Avni Bytyqi - policia shpesh mbajnë ligjerata dhe është kompetente për këtë.

Alban Berisha - në rregull,e bini një raport.A ka mundësi me pas një raport se sa OJQ janë subvencionu për parandalimin e dukurive negative.

Avni Bytyqi - në bazë të rregullores për financimin e OJQ-ve Komuna ka për obligim që të bëjë thirrje për subvencionimin e OJQ-ve.Të gjitha OJQ-të që konkurojnë me projekte konkrete dhe që i plotësojnë kushtet dhe kriteret në bazë të rregullores,komisioni ka për obligim ti subvencionojë.

Alban Berisha - unë e di që kush të aplikon e merr por e di edhe që aplikon e s'e merr.Te parandalimi i dukurive negative e din mire që është e ndane veqantë edhe në ligjin për rini,që ti ke të drejtë që vetëm për këtë dikaster me hap konkurs.

Shefket Kolgeci - pajtohem me parafolësit sepse vërtetë ka shqetësime.Në këtë rast jemi në kohën e nxehtë dhe rreziku më i madh është prej zjarreve dhe ne me mujt sa ma herët me pengu.Propozoj që në çdo fshat të vendoset numri i telefonit të zjarrëfikësave.

Kryetari - Ne i kemi 12 zjarrëfikësa,dhe prej tyre 4 ndërrime,nga 3 i kemi në ndërrim.Falemderoj qytetarët që vazhdimisht kanë dalë vullnetar. Kryetari përmend disa raste të zjarreve dhe thotë është pjesë e Ministrisë së Punëve të brendshme dhe qe dy vjet janë dy vende të lira.

Shefket Kolgeci - mendoj që në këtë rast ju Kryetar me bo pakt me Kryesitë e fshatrave,në mënyrë që kontakti i pare me qenë me kryesitë e fshatrave.

Kryetari - ku është komisioni që është bo në asamblenë komunale e që nuk ka bo asnjë lëvizje për formimin e kryesisë nëpër fshatra.

Shefket Kolgeci - komisionin duhet me udhëheq kryesuesi.

Enver Shabani - ne si Komunë e Suharekës kemi shpërnda apele nëpër të gjitha fshatrat ,nëpër qendra,markete,pra vende të dukshme ku janë edhe numrat e telefonit.Për herë të parë është themelu një organizatë për shuarjen e zjarreve,kurse vitin e kaluar kemi pas nëpër çdo lokalitet ekupe të përgaditura vullnetare.

Shefket Kolgeci - unë shkoj shpesh në Vraniq dhe nuk kam pa ndonjë pllakat me numër emergjent.

Selman Kolgeci - meqenëse u diskutu çështja e konsumimit te narkotikëve,Kryetar nuk po e shoh që e keni potencu një rast të drogës në Shirokë.Mendoj që do të duhej të potencohet se nëse është shpërnda te qytetarët,normalisht që e kish cenu edhe sigurinë në qytet.Çka keni bo si kryetar i komisionit për parandalimin e kësja dukurie?

Mimoza Bajraktari - desha të ndërlihem te shqetësimi i Albanit. Ai shqetësim është i gjithë prindërve të tjerë.Drejtoria e Arsimit dhe Shëndetësisë duhet bërë bashkë dhe të kenë grupe apo të caktohen persona që të mbajnë programe për grupmosha të ndryshme,d.m.th. prej klasave të pesta.

Urim Suka - Kryetari kur ka dasht me u bo Kryetar ka thënë që kena me rrit sigurinë nëpër shkolla dhe kena me bo këta e këta.Na sot kemi me analizu informatën që na keni sjellë dhe kjo informatë është jo serioze.Programet shkollore në kuadër të edukatës qytetare i trajtojnë edhe temat që përmendëm,por nuk prejashtohet që është edhe e nevojshme,që me pas bashkëpunim si tha edhe kolegja.Kryetar, hargjo energji si me i nal problemet dhe mos hargjo energji qysh me më kthy përgjigje mu.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - në ditën e çlirimit flamuri i Kosovës nuk ka qenë në asnjë shtizë dhe a ka qenë gabim i juai,apo i qeverisë apo sugjerim i dikuj,nuk kam informata.Kam dëshirë dhe kërkoj që në të ardhmen, sidomos ditën e çlirimit me qenë edhe flamuri i shtetit të Kosovës.Kam një kërkesë që sheshi nga Ura e Madhe e deri te rruga e Podrumit që ka alternativa për qarkullim,që të bllokohet qarkullimi për automjete nga ora 19:00 deri në orën 24:00.

Selman Kolgeci - shqetësimi im dhe i qytetarëve është për mirëmbajtjen e brezit rrugor përgjatë gjithë rrugëve lokale që janë kompetencë e Komunës sonë.Kur do të fillojë ky sanim apo e keni lënë në mëshirën e fatit deri në ndërrimin e stinës kur veq fillojnë bien gjethet.

Avni Bytyqi - sa i përket kërkesës së Shefketit,ligji për kounikacion rrugor ekskluzivisht i kategorizon rrugët dhe rruga që përmendet ju është rrugë regjionale dhe fatmirësisht kemi alternativë se ka me i drejtu automjetet dhe do ta shiqojmë mundësinë dhe Kryetari të merr një vendim në bazë të kërkesës së inspektorit të komunikacionit që ai rekomandon.

Enver Shabani - sikurse vitin e kalum që e kemi bo pastrimin e rrugëve lokale,edhe këtë vit Komuna u kujdes dhe ka nda 250 mijë euro buxhet dhe janë në procedurë të prokurimit sepse siq e dini buxheti u vonu,andaj presim të shkojmë me procedure të tenderimit.

Urim Suka - unë kam dy kërkesa.Këto ditë është bërë publike lista e emrave të OJQ-ve dhe individëve,përfitues të subvencioneve nga Drejtoria e Kulturës,dhe me këtë rast kërkoj nga drejtoresha që në mbledhjen e radhës apo dhe më shpejtë,të përgatit një raport ku do të na njoftonte me emrat e

përfituesve të subvencioneve, vlerën për secilin përfitues si dhe titullin e projektit me të cilin ka konkuru dhe cilat landë janë refuzu dhe arsyeja. E dyta ka të bëjë me organizimin e aktivitetve për shënimin e 13 Qershorit. A mund të na njoftoni sa mjete janë shpenzuar për organizimin e këtyre aktiviteteve dhe cila procedure është ndjekur në përzgjedhjen e kompanisë që i ka kryer këto shërbime. Pyetja për Drejtorinë e Shërbimeve Publike: Ndërtimi i rrugëve në lagjen Boka dhe Qarri në Grejçec. Për ndërtimin e këtyre rrugëve ju keni nda dhe shpenzuar 25 mijë euro në 2020 dhe në vitin 2021 keni shpenzuar 30 mijë euro për ndërtimin e rrugës në lagjen Boka -vazhdim dhe rrugën Qarri. Asnjëra nga këto rrugë nuk janë shtruar dhe sipas banorëve këto rrugë janë shtruar me zhavorr në vitin 2020. Kërkoj sqarime se çka ka ndodh me këto rrugë.

Lorika Gashi - sa i përket subvencioneve, jemi në përpilim e sipër të vendimeve. Sa i përket raportit që po kërkon, bëje një kërkesë zyrtare dhe e di që përgjegjësia mbetet mbi ty sepse ka individë tjerë që ndoshta s'kan qef me ditë. Sa i përket shpenzimeve të 13 Qershorit, e dimë që nuk kemi pas buxhet dhe disa janë kry me subvencione dhe disa me donacione. Janë faturat që don me marrë përgjigjen kurdo që je i interesun, dhe e bën kërkesën.

Urim Suka - unë po bëj kërkesë publike, dhe dua ta pyes juristin se a është kjo kërkesë zyrtare dhe a obligohet drejtoresha me ma përgadit atë raport që kërkoja.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që anëtari i Kuvendit gjatë seancës kurdoherë mund të kërkoj informacione nga drejtorët apo Kryetari i komunës. Nëse drejtori apo kryetari është i gatshëm ti jep informacionin aty për aty dhe nëse jo atëherë obligohet që mbledhjen e radhës ta përgatit përgjigjen me shkrim.

Lorika Gashi - për qasjen në dokumente zyrtare duhet të bëhet një kërkesë me shkrim.

Avni Bytyqi - sa për sqarim, ky nuk kërkoi qasje në dokumente por vetëm sa aplikime kanë qenë, sa janë shqyrtu, sa janë kthy positive dhe sa janë refuzu.

Lorika Gashi - mirëpo kërkoi emra dhe mbiemra.

Urim Suka - emrat e përfituesve veq kanë dalë. Përpjekja jote për me vazhdu debatin është për keqardhje. Të lutem ma përgatit raportin dhe ma sjell.

Enver Shabani - lidhur me investimet që janë bo në fshatin Grejçec, në vazhdimësi Komuna ka bërë investime. Sa i përket rrugës në fund që përmendët, tani këtë vit ne e kemi nda buxhetin dhe jemi në procedura të tenderimit dhe ajo do të shtrohet me asfalt.

Urim Suka - Drejtori e konstatoj që rrugët nuk janë shtru dhe tha që kena nda buxhet prap me i shtru. Po vërehet çka ka ndodh dhe ajo që qytetari ka thënë, paska pas të drjetë. Ndryshoni, ato që i qitni në letër dhe qoni në vend.

Kryetari - para dy viteve ajo rrugë u shtru, por atë rrugë vetëm asfalti e man. Kryetari tutje jep sqarime.

Urim Suka - Kryetar ju po e tjetërsoni muhabetin. Unë po të them, në letrat që ti i ke pru, shkrun: Ndërtimi i rrugës në Grejçec në lagjen Boka. Nuk është ndërtu por është bo me zall. Me ndërtu dhe me bo me zall dallon.

Kryetari - e ka shkatërru rrugën në Samadraxh komplet me kubëza, ka shkatërru edhe shumë rrugë me asfalt, nëse je dëshmitar e din që ka ndodh edhe në Peqan.

Qëndrim Elshani - vi me kërkesë të qytetarëve që e frekuentojnë rrugën "Hasan Prishtina". Ata ngren shqetësimin që aty po ka shumë rrezik prej makinave, pasi ajo rrugë nuk ka as ndriçim dhe as trotuar. Pyesin se a e ka plan Komuna me e zgjidh këtë problem dhe nëse po, kur. Kërkesa tjetër e

qytetarëve është për ata që ende nuk e kanë përfitu subvencionimin prej 100 euro për Kovid. Kur e ka në plan Komuna me nda këto pare.

Kryetari - është në përfundim qerdhja e fëmijëve dhe në moment që heken rrethojat do të bëhet trotuari në dy anët.

Besa Kuçi - ky është edhe shqetësim i imi personal dhe si drejtor. Unë kam një pyetje publike për Ministrinë e Financave, se kur e kanë në plan ata me na lëshu neve këtë shumë, pasi ky vendim ka kalu permes Asamblesë. Ne listat në drejtori ikemi gati dhe si të bartet shuma, ne i bëjmë pagesat.

Alban Berisha - kur ka pas ardh vendimi për me shfuqizu vendimin e për subvencionimin e Kovid, pata thane që shkaktarët hala nuk kanë shku. E tash a janë këta numra falls a çka janë dhe a do ta kthejmë vendimin?

Kryesuesi - jo.

Kryesuesi - drejtoresha e QKMF-së ka kërku sqarim ligjor sa i përket anëtarëve të Asamblesë që punojnë në ambulance për të drejtat dhe detyrat e kuvendit.

Avni Bytyqi - ligji për vetqeverisjen locale ,neni 39 flet për të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit paragrafi 6 dhe thotë; anëtarëve të Kuvendit ju lejohet të mungojnë nga vendi i punës për aq sa zgjasin seancat apo sa zgjasin punët përgaditore të Kuvendit.

Takimi përfundoi: 12:35

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj